

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË PËR  
PROJEKTIN “SPITALI UNIVERSITAR “NËNË TEREZA”, TIRANË, FAZA E  
PARË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Ministrinë e Shëndetësisë, për Projektin “Spitali Universitar “Nënë Tereza, Tiranë” me objekt “Kontroll i vlerësimit të veprimtarisë ekonomiko-financiare të projektit” për periudhën nga fillimi i projektit deri-në Qershor 2011, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 30 datë 07.03.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 342/7 datë 07.03.2012, dërguar Z. ■■■■■, Ministër i Shëndetësisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Ministria e Shëndetësisë, të analizojë efektivitetin e dërgimeve me shërbim jashtë vendit, për seminare apo vizita studimore, me qëllim mos prekjen më të fondeve të projekteve dhe investimeve me financime të huaja, të akorduar për zhvillimin e sektorit të shëndetësisë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen shpenzimet të cilat nuk janë në shërbim të projekteve, pasi nga fondet e projektit “Spitali Universitar “Nënë Tereza” Tiranë, faza e parë”, financuar nga CEB, janë përballuar në mënyrë të padrejtë shpenzime për udhëtim e dieta jashtë vendit, në kundërshtim me marrëveshjen e kredisë, duke shkaktuar efekt negativ financiar dhe rënduar koston e projektit në shumën 7 390 euro.

Trajtuar më hollësisht në pikën 3 të këtij Raporti Përfundimtar Kontrolli.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

2. Ministria e Shëndetësisë, më konkretisht drejtuesit e lartë të saj dhe Departamenti Juridik, të analizojë marrjen e vendimeve dhe efektivitetin e tyre, në lidhje me marrëveshjet financiare të kredive ose huave, të ratifikuara në Parlament për financimet dhe investimet e huaja, të dhënë për zhvillimin e sektorit të shëndetësisë, pasi për projektin “Spitali Universitar “Nënë Tereza” Tiranë, faza e parë”, financuar nga CEB, është marrë një vendim në kundërshtim me marrëveshjen e kredisë të ratifikuar, me ligjin nr. 9412, datë 20.05.2005, duke shkaktuar një efekt negativ financiar dhe rënduar koston e projektit në shumën 24 000 USD.

Trajtuar më hollësisht në pikën 3 të këtij Raporti Përfundimtar Kontrolli.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

3. Ministria e Shëndetësisë, në të ardhmen të marrë masa që ndryshimet e komponentëve të marrëveshjeve financiare të kredive ose huave të ratifikuara në Parlament për financimet dhe investimet e huaja, të dhënë për zhvillimin e sektorit të shëndetësisë, të jenë të miratuara me shkrim nga të gjitha palët pjesëmarrëse të marrëveshjeve, si financuesit ashtu edhe përfituesit, pasi për projektin “Spitali Universitar Nënë Tereza Tiranë, faza e parë”, financuar nga CEB, nuk është marrë miratimi nga CEB dhe MF, për tejkalimin e komponentit “Kosto administrative e PIU-t”, në kundërshtim me marrëveshjen e kredisë, duke rënduar me të padrejtë koston e projektit në shumën 4 506 USD.

Trajtuar më hollësisht në pikën 3 të këtij Raporti Përfundimtar Kontrolli.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

4. Drejtoria e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, të marrë masa për plotësimin me stafin e specializuar mjekësor, për të gjitha repartet e shërbimeve, pasi këto reparte janë të kompletuara me pajisjet e duhura mjekësore, por nuk janë vënë në punë, ndonëse pajisjet mjekësore janë instaluar brenda vitit 2010, si dhe u ka përfunduar garancia për defekte pa u vënë në punë, duke bërë që investimi i kryer të mos jetë efektiv.

Trajtuar më hollësisht në pikat 2 dhe 5 të këtij Raporti Përfundimtar Kontrolli.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

5. Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, të marrin masa për kalimin e pajisjeve mjekësore në vlerën 2 milionë USD, të financuara nga Banka Botërore, në kuadër të projektit “Rimëkëmbja e sistemit shëndetësor”, në spitalin e ri, në përputhje me marrëveshjen e kredisë të CEB të ratifikuar me ligjin nr. 9412, datë 20.05.2005.

Trajtuar më hollësisht në pikat 2 dhe 5 të këtij Raporti Përfundimtar Kontrolli.

*Menjëherë*

6. Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria Ekonomike, të marrë masa që në të ardhmen, të bëjë një planifikim më të saktë vjetor në lidhje me kostot lokale dhe TVSH, për projektet dhe investimet me financime të huaja në sektorin e shëndetësisë, ku në bazë të marrëveshjeve financiare të ratifikuara në Kuvend, këto kosto përballohen nga Buxheti i Shtetit, me qëllim që mos të ketë vonesa në përfundimin në afat të projekteve, pasi për projektin “Ndërtimi i fazës së parë të QSUT “Nënë Tereza”, mospagesa në kohë e koston lokale dhe TVSH, ka sjellë vonesa në realizimin e projektit brenda afatit të përcaktuar në marrëveshjen e kredisë.

Trajtuar më hollësisht në pikën 2 të këtij Raporti Përfundimtar Kontrolli.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

7. Ministria e Shëndetësisë, të marrin masa për arkivimin e të gjitha dosjeve të projektit të përfunduar “Faza e parë e ndërtimit të Spitalit Universitar “Nënë Tereza”, Tiranë”, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Trajtuar më hollësisht në pikën 4 të këtij Raporti Përfundimtar Kontrolli.

*Menjëherë*

## **B. MASA ZHDËMTIMI**

1. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **89 500 USD** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria konsulente [REDAKTUAR] për mos derdhjen e tatimit mbi të ardhurat e përfituara në Shqipëri, në kundërshtim me nenin 24 kreut II, të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për Procedurat tatimore” me ndryshimet përkatëse, si dhe të udhëzimeve përkatëse të nxjerra në zbatim të tij, si dhe me germën “d”, të nenit 33 të kreut IV, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” me ndryshimet përkatëse, si dhe të udhëzimeve përkatëse.

Trajtuar më hollësisht në pikën 3 të këtij Raporti Përfundimtar Kontrolli.

*Menjëherë*

2. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **4 992 USD** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë e përfituar padrejtësisht nga shoqëria konsulente [REDACTED] për rritje të pagesës mujore në Amendamentin nr. 3 të kontratës nga ajo e ofertuar dhe e kontraktuar, për dy nga pozicionet (planifikuesin e pajisjeve dhe inxhinierin mekanik), veprim në kundërshtim me “Aneksi 4A”, “Detajimi i pagesës” të kontratës së lidhur.

Trajtuar më hollësisht në pikën 4 të këtij Raporti Përfundimtar Kontrolli.

*Menjëherë*

### **C. MASA DISIPLINORE**

*Shënim:* Do rekomandonim masë disiplinore “Vërejtje me shkrim”, për këta persona; znj. [REDACTED], dhe z. [REDACTED], sipas përgjegjësive të përcaktuara në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, por meqenëse këta persona janë larguar nga detyra që kanë mbajtur gjatë zbatimit të projektit masat disiplinore konsiderohen të ezauruara.

Gjithashtu do rekomandonim masën disiplinore, “Vërejtje me shkrim”, për [REDACTED] sipas përgjegjësive të përcaktuara në Raportin Përfundimtar të Kontrollit, por meqenëse ky person ka qenë me kontratë të pjesshme konsulence me afat deri në përfundim të projektit dhe meqenëse projekti ka përfunduar, masa disiplinore konsiderohet e ezauruar.

Në vijim do të njoftohet Drejtoria e Administratës Publike, për personat e lartpërmendur.

*Shënim:* Auditimi i krye nga audituesit Yllka Pulashi, Albana Pengili, Lavdie Fshazi, Luljeta Shtylla, më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**